



## VENDIM

*Nr. 22, Datë 15.02.2017*

### MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP  
PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET  
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE,  
AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE  
PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT  
UNIVERSAL PËR PERIUdhËN KOHORE 01.01.2017 – 31.12.2017**

Në mbështetje të neneve 16, 20 gërma “h” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 5 të VKM Nr.244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.02.2017, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike, në lidhje me miratimin e Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/ KESH sh.a dhe furnizuesit të shërbimit universal, OSHEE SH.A., për periudhën kohore 01 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2017.

### Konstatoi :

- Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.”
- Shoqëria OSHEE sh.a me shkresën me nr. 31125 Prot., datë 23.12.2016 ka përcjellë në ERE për dijeni draft-kontratën për shit-blerjen e energjisë

elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/ FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2017 – 31.12.2017.

- Shoqëria KESH sh.a me shkresën nr. 88 Prot., datë 09.01.2017 ka përcjellë në ERE për dijeni draft – kontratën për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/ FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2017 – 31.12.2017.
  - Në ERE ka mbërritur edhe shkresa me nr. 1517 Prot., datë 18.01.2017 e shoqërisë OSHEE sh.a e cila bën me dije se nuk është dakort me nënshkrimin e draftit të dërguar nga shoqëria KESH sh.a të kontratës për shit- blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/ FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2017 – 31.12.2017.
  - Palët kanë një sërë mosdakortësish në lidhje me termat dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a.
  - ERE me herët ka miratuar me Vendimin nr.144, datë 25.08.2016, kontratën e sipërcituar për periudhën 1 korrik 2016 - 31 dhjetor 2016.
  - Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a për furnizimin me energji elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal në përputhje me sa referuar më sipër, është e rregulluar.
- Ë Çështjet për të cilat nuk kanë gjetur dakortësinë palët në procesin e negociimit të kësaj marrëdhënieje, duhet të jenë objekt i diskutimit me palët në kuadër të procedurave që ERE do të zhvillojë deri në finalizimin e kontratës për periudhën 1 Janar -31 Dhjetor 2017.
- Ë ERE duke konstatuar mosdakortësinë e palëve me njëri tjetrin mbi draftin e kontratës për shit- blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë KESH dhe OSHEE/ FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2017–31.12.2017, me iniciativën e vet, propozon fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e draft kontratës së miratuar më herët me vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.08.2016.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për miratimin e Kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a, sipas draftit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.08.2016, për periudhën një vjeçare, 01.01.2017 – 31.12.2017.
2. Shtyrjen e afatit të vendosur në kontratën e miratuar nga ERE me vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.08.2016, deri në miratimin e kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a, për periudhën një vjeçare, 01.01.2017 – 31.012.2017
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a , KESH sh.a, dhe MEI për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**